

Numri: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Mbrojtësi i specializuar i Hashim Thaçit

Data: 17 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrimet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësi i Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësi i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësi i Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësi i Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

I. HYRJE

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën kundër z. Hashim Thaçi,¹ lëshoi një fletarrestim kundër tij² dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) në Hagë.³
2. Në fillim të nëntorit 2020, z. Hashim Thaçi u vetëdorëzua tek zyrtarët e DHSK-së në Kosovë, sipas një marrëveshjeje të mëparshme me ta, dhe mandej u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë.
3. Më 9 nëntor 2020, z. Hashim Thaçi u vetëdeklarua i pafajshëm për akuzat kundër tij gjatë paraqitjes së tij të parë.⁴
4. Më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Urdhër për caktimin e datën së konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për parashtrime”,⁵ me anë të të cilit ai urdhëronte thirrjen e një konference mbi ecurinë e çështjes më 18 nëntor 2020 dhe ftonte palët të paraqisnin parashtrimet e tyre për pikat e rendit të ditës bashkëngjitur urdhrin të tij, për sistemin e redaktimit që do të zbatohet në këtë proces gjyqësor; dhe/ose për të tjera tema relevante që konsiderohen të nevojshme.
5. Më 13 nëntor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti “Parashtrimet e Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes”.⁶

¹ Shih KSC-BC-2020-06/F00045/A03, Aktakuza e redaktuar më tej, 4 nëntor 2020.

² KSC-BC-2020-06/F00027/A01/RED, Fletarrestim për Hashim Thaçin, 26 tetor 2020.

³ KSC-BC-2020-06/F00027/A02, Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 26 tetor 2020.

⁴ KSC-BC-2020-06, Projekt-transkript, 9 nëntor 2020.

⁵ KSC-BC-2020-06/F00074.

⁶ KSC-BC-2020-06/F00076.

6. Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja") paraqet parashtrimet e saj për pikat e renditura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në rendin e ditës së konferencës mbi ecurinë e çështjes.⁷

II. PARASHTRIME

A. ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

7. Mbrojtja synon të hetojë secilën prej akuzave të ngritura në Aktakuzë kundër z. Hashim Thaçi. Në këtë drejtim, Mbrojtja thekson se vazhdon të jetë ende në pritje që t'i jepet një version konfidencial i Aktakuzës, me më pak redaktime.

8. Si pasojë, Mbrojtja kërkon që ZPS-ja të urdhërohet të bëjë të njohur për Mbrojtjen një version të paredaktuar ose, më së paku, një version të Aktakuzës me më pak redaktime, brenda 3 ditësh pas konferencës mbi ecurinë e çështjes.

9. Lidhur me hetimet e Mbrojtjes, në këtë fazë, është tepër herët për të dhënë ndonjë vlerësim të qartë për afatin e nevojshëm, në veçanti, duke pasur parasysh pandeminë e COVID-19 që pa dyshim do të ketë një ndikim të madh në hetimet, për të mos thënë, do t'i ndalojë ato.

10. Duke pasur parasysh numrin e dëshmitarëve të cilët Prokuroria synon t'i përdorë në gjykim (rreth 200), numrin e dokumenteve që do t'i bëhen të njohura Mbrojtjes (rreth 1800 materiale inkriminuese, 100000 materiale sipas rregullës 102(3) dhe mbi 1000 materiale potencialisht shfajësuese), dhe afatin e sugjeruar për nxjerrjen e tyre (31 maj 2021),⁸ nga përvoja në çështje të tjera Mbrojtja vlerëson se do t'i duhen

⁷ KSC-BC-2020-06/F00074, 11 nëntor 2020, publik.

⁸ KSC-BC-2020-06/F00076, Parashtrimet e Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes, para. 2, 5-6, 12, 16-17.

të paktën tetëmbëdhjetë muaj për të asimiluar materialin e Prokurorisë, për të marrë udhëzime, për të kryer hetime të mirëfillta dhe ndryshe për t'u përgatitur për gjykim.

11. Në këtë fazë Mbrojtja nuk do të japë njoftim për alibi apo ndonjë arsye që përjashton përgjegjësinë penale, por rezervon të drejtën ta bëjë këtë duke u bazuar në nxjerrjen e materialeve dhe hetimet.

B. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E PROVAVE

1. Nxjerrja e provave për Gjykatësin e Procedurës Paraprake

12. Mbrojtja thekson se në çështjen *Mustafa*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkoi që t'i bëheshin të njohura të gjitha provat e shkëmbyera midis palëve, pavarësisht nëse do të përdoren apo nuk do të përdoren në gjykim.⁹

13. Mbrojtja e kundërshton fuqimisht nxjerrjen për Gjykatësin e Procedurës Paraprake të të gjitha materialeve në përgjithësi, duke qenë se kjo nuk i duket e nevojshme dhe nuk parashihet as në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji për DHSK-në"), as në Rregulloren e Procedurës dhe Provave ("RRPP").

14. Një nxjerrje e tillë materialesh për Gjykatësin e Procedurës Paraprake do të cenonte Mbrojtjen, duke qenë se çdo material që i bëhet i njohur Gjykatësit të Procedurës Paraprake, do t'i kalohet trupit gjykues që do të caktohet eventualisht, sipas rregullës 98 të RRPP-së, "Kalimi i dosjes së çështjes trupit gjykues", e cila parashikon që:

"(1) Pas marrjes së parashtrimeve nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja bazuar në rregullën 95(4-

⁹ KSC-BC-2020-05/F00034, Vendim kornizë për nxjerrjen e provave dhe për çështje të lidhura me të, 9 tetor 2020, para. 34.

5) dhe rregullën 97 dhe brenda tridhjetë (30) ditësh pas daljes së çdo vendimi të formës së prerë në lidhje me mocione paraprake, **gjykatësi i procedurës paraprake i kalon trupit gjykues dosjen e plotë të çështjes gjyqësore e cila përmban:**

(a) aktakuzën e konfirmuar së bashku me materialin mbështetës sipas rregullës 86(3);

(b) të gjitha parashtrimet dhe materialet e dorëzuara nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit gjyqësor;

(c) çfarëdo provash të administruara që nuk përmenden në paragrafin (1)(b);

(d) çfarëdo letërkëmbimi në lidhje me çështjen që nuk është dorëzuar në Njësinë e Administrimit të Gjykatës;

(e) një dokument dorëzues që përfshin:

(i) argumentet e palëve dhe nëse është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, në lidhje me faktet dhe ligjin përkatës;

(ii) pikat për të cilat palët pajtohen;

(iii) listën e urdhrave dhe vendimeve të dhëna nga gjykatësi i procedurës paraprake;

(iv) provat e paraqitura nga secila palë;

(v) sugjerime në lidhje me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren;

(vi) pikat e kundërshtuara faktike dhe ligjore;

(vii) ecurinë e nxjerrjes së materialeve;

(viii) të gjitha mbledhjet me palët; dhe

(ix) çfarëdo çështje tjetër të pazgjidhur;

(f) kërkesa dhe vendime në lidhje me nxjerrjen e materialit; dhe

(g) çfarëdo materiali tjetër që ka lidhje me çështjen.

(2) Kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore bazuar në paragrafin (1), kryhet në mënyrë elektronike.

(3) Para kalimit të dosjes së çështjes sipas paragrafit (1), gjykatësi i procedurës paraprake informon në lidhje me sa më lart dhe në kohë Kryetarin, për të mundësuar caktimin në kohë të një trupi gjykues."

15. Së paku, një material i tillë nuk duhet t'i kalojë automatikisht trupit gjykues që do të caktohet eventualisht në çështjen aktuale. Trupi gjykues mund të ketë qasje vetëm në ato prova që palët synojnë të paraqesin formalisht si prova materiale në gjykatë. Në fakt, do të ishte e padrejtë ndaj Mbrojtjes që trupi gjykues të kishte qasje, të shqyrtonte dhe më në fund të krijonte opinionin e vet mbi prova të shkëmbyera midis palëve, por për të cilat nuk synohej të paraqiteshin në gjykim.

2. Nxjerrja e materialeve *inter partes*

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka ftuar palët që t'u përgjigjen disa pyetjeve lidhur me procedurën e nxjerrjes së materialeve:

"7. Procedura e nxjerrjes së materialeve.

a) A munden palët të paraqesin së bashku me çdo paketë materialesh që bëhen të njohura, një tabelë që e kategorizon informacionin sipas akuzave të Aktakuzës së Konfirmuar, me

referenca konkrete ndaj krimeve bazë, elementëve kontekstualë të krimeve, sjelljes së pretenduar të të akuzuarve, apo sipas rastit, ndaj provave që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar;

b) A mundet palët të propozojnë një tabelë standarde (që përmbush kriteret e rregullës 109(c) të Rregullores) që do të diskutohet në konferencën mbi ecurinë e çështjes;

c) Nëse kjo nuk është e realizueshme, cili do të ishte propozimi alternativ i palëve që gjithsesi do të përmbushte kushtin e relevancës dhe shkallën e saktësisë të parashikuar në rregullën 109(c) të Rregullores dhe do të jepte orientim të mirëfilltë për palën marrëse dhe Gjykatësin e Procedurës Paraprake; dhe

d) A pajtohet Mbrojtja që t'i jepet një tabelë përmbledhëse në kohën e dorëzimit të dosjes paraprake prej ZPS-së; për analogji, a pranon ZPS-ja që t'i jepet një tabelë përmbledhëse në kohën e dorëzimit të dosjes paraprake prej Mbrojtjes.

17. Mbrojtja konstaton se rregulla 109(c) e RRPP-së parashikon që:

"Për aq sa është e realizueshme, pala: (...) e kategorizon informacionin në përputhje me akuzat e aktakuzës, duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementet kontekstualë të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provat që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar."

18. Rregulla 95(4) parashikon që:

"Pas dorëzimit prej Prokurorit të Specializuar të materialeve të përmendura në paragrafin (4), gjykatësi i procedurës paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen paraprake e cila përmban:

(a) një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së mbrojtjes së të akuzuarit;

(b) akuzat dhe pikat që i akuzuari kundërshton, duke përmendur paragrafët konkretë në dosjen paraprake të Prokurorit të Specializuar dhe arsyet e kundërshtimit të të akuzuarit ndaj tyre; dhe

(c) një listë të dëshmitarëve të mundshëm që Mbrojtja synon të thërrasë e cila nuk paragjykon ndryshime të mëvonshme të listës ose paraqitjen e këtyre ndryshimeve. Për çdo dëshmitar, Mbrojtja saktëson se me cilin aspekt përkatës konkret lidhet dëshmia e dëshmitarit."

19. Duke pasur parasysh këto kritere, Mbrojtja parashtron se, në kohën e nxjerrjes së çdo materiali, pala nxjerrëse vë në dukje, për aq sa është e realizueshme, dhe përmes meta të dhënave të disponueshme në *Legal WorkFlow*, nëse materiali në fjalë lidhet kryesisht me krimet bazë, elementët kontekstualë, sjelljen e të akuzuarit ose, sipas rastit, me provat që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar. Më tej, tabela përkatëse mund të nxirret përmes eksportimit të meta të dhënave përkatëse të regjistruara për çdo dokument dhe të bashkëngjitura secilit parashtrim që njofton paketën e materialeve të nxjerra.

20. Në vijim, secila palë duhet të dorëzojë tabelën përmbledhëse pas parashtrimit të dosjes së saj paraprake që do të përfshinte të gjithë provat që pala synon të paraqesë në gjykatë. Secilës palë i duhet dhënë kohë e mjaftueshme për paraqitjen e një tabele të tillë brenda 15 ditësh.

C. SISTEMI I REDAKTIMIT

21. Në këtë fazë dhe teorikisht, Mbrojtja nuk ka ndonjë konstatim të veçantë lidhur me sistemin e redaktimit të miratuar në çështjen *Mustafa*.¹⁰

D. TË NDRYSHME /LIRIMI I PËRKOHSHËM

22. Sikundër u tha gjatë paraqitjes së parë të z. Hashim Thaçi, vendimi për arrestim dhe jo për thirrjen e tij është befasues dhe shqetësues.¹¹ Gjithashtu, ai nuk pasqyron as historikun e kësaj çështjeje. Duhet mbajtur parasysh se z. Hashim Thaçi ka bashkëpunuar me DHSK-në në të gjitha fazat. Ai pranoi të intervistohej nga ZPS-ja. Gjithashtu, pas daljes së Aktakuzës, ai vetë dha dorëheqjen nga posti i tij si President i Kosovës dhe iu dorëzua vullnetarisht personelit të DHSK-së në Kosovë.

23. Në këtë kontekst, Mbrojtja synon të kërkojë sa më herët lirimin e përkohshëm të tij sipas rregullës 57(3) të RRPP-së. Mbrojtja nuk pati mundësi që ta bënte një kërkesë të tillë në mënyrë të informuar më parë, meqenëse asaj iu dha materiali dhe argumentet e paraqitura nga ZPS-ja në mbështetje të kërkesës së saj për fletarrestim vetëm më 16 nëntor 2020. Gjithashtu, nëse Prokuroria e kundërshton një kërkesë të

¹⁰ KSC-BC-2020-05/F00034, Vendim kornizë për nxjerrjen e provave dhe për çështje të lidhura me të, 9 tetor 2020, para. 77-89.

¹¹ KSC-BC-2020-06, Projekt-transkript i paraqitjes së parë të z. Hashim Thaçi, 9 nëntor 2020, f. 45 & e më pas.

tillë për lirim të përkohshëm, Mbrojtja duhet të informohet plotësisht dhe në mënyrë të drejtë në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së mundshme të çfarëdo dhe të gjitha argumenteve dhe materialeve të mëtejshme nga Prokuroria, përpos atyre të paraqitura Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

24. Mbrojtja me respekt i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të organizojë një seancë për të dëgjuar parashtrimet e palëve lidhur me kërkesën e z. Hashim Thaçi për lirim të përkohshëm, seancë që do të zhvillohet në një kohë të përshtatshme për të gjitha palët jo më herët se 14 ditë pas konferencës mbi ecurinë e çështjes.

25. Lidhur me procedurën e përshtatshme për të vendosur mbi kërkesat për lirim të përkohshëm, Mbrojtja parashtron se një seancë gojore në prani të z. Hashim Thaçi është e nevojshme, duke pasur parasysh çfarë është në diskutim, pra, liria e ish-Presidentit të Kosovës, për krime që pretendohet se janë kryer 22 vite më parë, që ai e kundërshton, dhe duke pasur parasysh se kjo do të jetë mundësia e parë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të dëgjojë parashtrimet e Mbrojtjes për këtë pikë, të bazuara në informacion.

26. Duke u bazuar në nenin 39(13) të Ligjit për DHSK-në dhe rregullën 75(2) & (3) të RRPP-së, e cila parashikon që:

“(2) Përgjithësisht dhe sipas gjykimit të panelit, parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve në proces, urdhrat dhe vendimet në lidhje me çështje rutinore apo çështje të cilat nga aspekti faktik dhe juridik nuk janë aspak, ose janë fare pak komplekse, bëhen ose paraqiten gojarisht. ²Urdhra dhe vendime të tilla shoqërohen ose pasohen me arsyetim me shkrim kur kjo është e nevojshme për sqarimin ose zbatimin e tyre. ³Administratori dokumenton çdo urdhër ose vendim të dhënë gojarisht.

(3) Pa cenuar paragrafin (2) dhe në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe me një urdhër ose në Rregullore, parashtrimet me shkrim të palëve gjatë procesit gjyqësor nuk pasohen me argumentime gojore.”

Mbrojtja parashtron më tej se parashtrimet e tjera me shkrim të paraqitura fillimisht nga Prokuroria dhe për të cilat Mbrojtja është përgjigjur, do të ndihmonin në paraqitjen dhe zgjidhjen e argumentimeve përkatëse që do të paraqiten në seancë.

27. Duhet të kihet parasysh se Gjykatësit të Procedurës Paraprake gjithsesi do t'i duhet të shqyrtojë mbajtjen në paraburgim të z. Hashim Thaçi pas dy muajsh nga vendimi i fundit lidhur me paraburgimin e tij, pra, nga 26 dhjetori 2020, sipas rregullës 57(1) të RRPP-së.

[Numri i fjalëve (në origjinal): 2186]

/nënshkrim/

Deivid Hupër

Mbrojtësi i Specializuar i Hashim Thaçit

E hënë, 17 nëntor 2020

Në Arushë, Tanzani